REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA - KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E SHËNDETËSISË/MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH
Njësia Org. / Org.Jedinica / Org. Unit 02
Nr.Prot: / Broj Prot. / Prot.No. 05-4801
Nr.i faqeve / Broj stranica / No.pages -4-
Data: / Datum: / Date: 08 / 07 / 2026
Prishtinë / a

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Shëndetësisë/Ministry of Health/Ministarstvo Zdravstva

PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE/PSO

EMRI I PSO: DETEKTIMI I CHLAMYDIA TRACHOMATIS NË MOSTRAT GJENITALE ME TESTIN IMAGEN-IMUNOFLUORESHENCË DIREKTE (ITGJ07/V1.0)

PËRMBAJTJA: DOKUMENTI PËRFSHIN HAPAT KRYESORË TË DETEKTIMIT TE CHLAMYDIAS TRACHOMATIS NË MOSTRAT GJENITALE ME TESTIN IMAGEN-IMUNOFLUORESHENCE DIREKTE, DUKE SIGURUAR QË TESTIMI TË KRYHET NË MËNYRË TË SAKTË DHE TË STANDARDIZUAR PËR DETEKTIMIN E CHLAMYDIA TRACHOMATIS

VERSIONI: 1.0
DATA E APROVIMIT: 07.07.2026
AUTOR: MSH/IKSHPK
NR. I HAPAVE: VI
NR. I NËNHAPAVE: 33

APROVUAR: Jahë Gecaj
U.D. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Shëndetësisë

V.V

REPUBLIKA E KOSOVËS - QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA - MINISTRIA E SHËNDETËSISË - MINISTARSTVO ZDRAVLJA - MINISTRY OF HEALTH
Prishtinë / a

QËLLIMI	QËLLIMI I KËSAJ PSO ËSHTË TË SIGUROJË NJË QASJE TË STANDARDIZUAR PËR DETEKTIMIN E CHLAMYDIAS NE MOSTRAT GJENITALE ME TESTIN IMAGEN-IMUNOFLUORESHENCE DIREKTE.
NDËRLIDHJA ME AKTET	• LIGJI NR. 08/L-200 PËR PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJEVE NGJITËSE, • PLANI STRATEGJIK KOMBËTAR PËR LABORATORE 2024-2030; • DORACAKU PËR MENAXHIMIN E CILËSISË NË LABORATORË; • EUCAST CLINICAL BREAKPOINTS AND DOSING OF ANTIBIOTICS 2025.
LISTA E SHKURTESAVE	• PSO - PROCEDURA STANDARDE OPERATIVE; • PPM - PAJISJET PERSONALE MBROJTËSE; • ITGJ- INFEKSIONET E TRAKTIT GJENITAL • FITC-FLUORESCEIN ISOTHYACIANATE CONJUGATE; • PBC-PHOSPHATE BUFFER SALINE.

PROCEDURA

Nr.	HAPI	NËN-HAPAT
[I]	Zbatimi i masave për menaxhim të mostrave	1. Mostra merret nga personeli shëndetësor/gjinekologu/urologu; 2. Mostra transportohet deri në laboratorin e diagnostikimit të mostrave gjenitale; 3. Laboranti kryen pranimin, inspektimin dhe ndarjen sipas kritereve të pranimit/refuzimit të përcaktuara në Doracakun e Cilësisë.
[II]	Reagjentët dhe pajisjet që janë të nevojshme për testim	1. Pajisjet përfshijnë: a. Mikroskop fluoreshent me filtër FITC; b. Kabinet i sigurisë biologjike Klasa II; c. Mikropipeta 20–200 µl; d. Timer laboratorik; e. Frigorifer 2–8°C; f. Centrifugë (kur kërkohet sipas procedurës); g. Vorteks; h. Termometër laboratorik. 2. Reagjentët e nevojshëm: a. IMAGEN™ Chlamydia Direct IF Test Kit; b. Reagjenti konjugat fluoreshent anti-Chlamydia; c. Reagjenti fiksues; d. Solucion larës PBS; e. Vaj imersioni; f. Kontrollet pozitive dhe negative të kompletit; 3. Materiali: a. Llamina mikroskopike; b. Lamela; c. Strisho sterile Dacron/Rayon; d. Dorëza njëpërdorimëshe; e. Qese Biohazard; f. Pajisjet Personale Mbrojtëse (PPM).
[III]	Veprimet laboratorike të marrjes dhe transportit të mostrës	1. Mostra merret nga endocerviksi, uretra ose lokacion tjetër gjenital sipas kërkesës klinike; 2. Strishoja futet në zonën e marrjes së mostrës dhe rrotullohet disa herë për të siguruar marrjen e qelizave epiteliale; 3. Mostra vendoset në mediumin transportues të rekomanduar. 4. Mostra etiketohet me: 5. ID e pacientit; a. datën dhe orën e marrjes; b. llojin e mostrës; 6. Mostra transportohet në laborator sa më shpejt që të jetë e mundur; 7. Mostrat ruhen dhe transportohen në 2–8°C nëse përpunimi nuk kryhet menjëherë;

		8. Mostrat e papërshtatshme, të paetiketuara ose të dëmtuara refuzohen sipas procedurës së cilësisë;
[IV]	Veprimet laboratorike të testimit	1. Mostra përzihet sipas procedurës së kompletit; 2. Materiali klinik shpërndahet në lamelën mikroskopike; 3. Preparati lihet të thahet në temperaturë ambienti; 4. Preparati fiksohet sipas udhëzimeve të kompletit IMAGEN™; 5. Shtohet konjugati fluoreshent; 6. Inkubohet sipas kohës së përcaktuar nga prodhuesi; 7. Preparati lahet me PBS; 8. Thahet dhe montohet me lamelë; 9. Ekzaminohet në mikroskop fluoreshent.
[V]	Interpretimi i rezultateve	1. Mikrobiologu ekzaminon preparatin në zmadhimin përkatës; 2. Rezultati konsiderohet pozitiv kur identifikohen trupëzat elementare me fluoreshencë karakteristike të gjelbër të ndezur; 3. Rezultati konsiderohet negativ kur nuk vërehen trupëza elementare karakteristike; 4. Kontrollet pozitive dhe negative duhet të japin rezultatet e pritura para validimit të serisë; 5. Mikrobiologu regjistron rezultatin përfundimtar të testimit.
[VI]	Veprimet e laboratorike të raportimit të rezultatit	1. Laboranti vendos të dhënat në sistemin informativ laboratorik; 2. Rezultatet regjistrohen në librin e protokollit ose databazën laboratorike; 3. Mikrobiologu verifikon saktësinë e testimit; 4. Rezultati raportohet si: a. Testi i imunofluoreshences direkte per detektimin e Chlamydia trachomatis ka rezultuar **NEGATIV**; b. Testi i imunofluoreshences direkte per detektimin e Chlamydia trachomatis ka rezultuar **POZITIV**; 5. Raporti nënshkruhet dhe validohet nga mikrobiologu përgjegjës.